



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUKË

KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin e Figurave

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.1 datë 16.07.2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 9 datë 08.07.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për Dhënien e titullit "Qytetar Nderi" Perlat Sheqeri i Bashkisë Pukë"

Analiza ligjore: Projekt vendimi është në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa "m"; ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë.

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Anëtarët e Komisionit janë njohur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore mbi rolin dhe kontributin e Z. Perlat Sheqeri, *Për kontributin e tij të veçantë në ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e artit e kulturës pukjane dhe kombëtare; si artist i spikatur në fushën e muzikës, këngëtar dhe interpretues me vlera të veçanta artistike; për përfaqësimin dinjitoz të Pukës në Festalet Folklorike Kombëtare dhe Mbarëkombëtare, duke lartësuar vlerat shpirtërore dhe traditën kulturore të krahinës, si dhe për bashkëpunimin e vyer me institucionet kulturore të Bashkisë Pukë, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në gjallërimin dhe pasurimin e jetës kulturore e artistike të qytetit.*

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin e Figurave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimit.

Impakti social / grupet që preken: Projekti impakton jetën e të gjitha shtresave, kategorive të varfra në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi me publikun

Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin e Figurave, i mbledhur me datën 16.07.2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. 9 datë 08.07.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për Dhënie të titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë" Perlat Sheqeri, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit

(emri, mbiemri, firma) **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma) **Sekretar i Komisionit**

Bezon Kuci



Datë 16.07.2026